



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Kamëz, më 01.03.2022

Njoftim Publik

Bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me Nr. ¹²⁸⁷ Prot, Dt. ^{24/01/2022} "Mbi projektin për subvencionimin e interesave të kredisë " njoftohen të gjithë qytetarët e interesuar të paraqesin aplikimet e tyre për " Programin Social të Strehimit për "Subvencionimin e interesave të kredisë pranë Bashkisë Kamëz nga data 04/03/2022 deri më 03/04/2022 (Faza e Parë).

Programi Social i Strehimit për "Subvencionimin e interesave të kredisë" synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e tyre të jetesës.

Kriteret bazë për paraseleksionimin e kërkesës së paraqitur nga individët/familjet e interesuara për të përfituar nga programi social strehimit për "Subvencionimin e interesave të kredisë" janë:

- > individët të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mbushur moshën 18 vjeç;
- > familjet të cilat në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kanë në pronësi një banesë;
- > familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit bazuar në ligjin 22/2018 "Për Strehimin Social "
- > familjet që zotërojnë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3 -Të ardhurat minimum dhe maksimum të përfituesve potencialë

Struktura familjare	Struktura apartamentit	Kufiri maksimal i kredisë/familje	Të ardhurat Maksimale	Shpenzimet INSTAT 2018	Niveli minimal i të ardhurave
1-2	Garsonier	2,600,000	93.036	46.146	26.000
3	1+1	3,120,000	111.465	62.651	26.000
4	2+1	3,640,000	115.294	77.521	26.000
5-6	3+1	4,420,000	114.838	83.733	31.058

Programi i subvencionimit të interesave të kredive do të targëtojë familje/individë që nuk disponojnë banesë në pronësi. Përparësi në përzgjedhje do të kenë:

- Çiftet e reja dhe të rinj me moshë jo më të madhe se 35 vjeç;

- individë /familje të minoritetit rom e egiptian;
- gra kryefamiljare / gra të dhunuara;

Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit

Teuta CAMI

